



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R
Nr. 300 Datë 5. 11. 2004

PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT DHE CAKTIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT TË
JURISTEVE - OFICER TË POLICISË GJYQËSORE TË PROKURORISË

Me synim, vlerësimin e punës dhe të aftësive profesionale të juristeve-oficer të policisë gjyqësore te Prokurorive;

Në mbështetje, të nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë " dhe të nenit 11 të ligjit Nr. 8679 datë 2. 11. 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", si dhe në vijim të Urdherit Nr. 201 date 06. 07. 2004 "Për vlerësimin e punës të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në Prokurori;

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale të juristëve-oficerë të policisë gjyqësore në Prokuroritë e shkallës së parë dhe në Prokuroritë e Apeleve.
2. Komisioni i vlerësimit të përbëhet nga:
 - Z. Halim ISLAMI, pedagog i të Drejtës Procedurale Penale në Shkollën e Magjistraturës;
 - Z. Artan HOXHA, anëtar i Gjykatës së Lartë dhe pedagog i të Drejtës Procedurale Penale në Shkollën e Magjistraturës;
 - Z. Skender KACUPI, shef i Departamentit Penal në Fakultetin e Drejtësisë dhe pedagog i të Drejtës Penale në Shkollën e Magjistraturës;
 - Z. Kujtim LULI, drejtor i Drejtorisë së Studimeve në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe pedagog i të Drejtës Penale në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës;
 - Z. Arqile KOÇA, prokuror në Drejtorinë K/Kriminal të Organizuar në këtë Zyrë
3. Caktimin e procedurave për organizimin e testimit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të juristëve-oficerë te policisë gjyqësore të Prokurorisë, Aneksi Nr. 1 bashkëlidhur këtij urdhri.
4. Testimi të kryhet, në datat 20, 27 nëntor dhe 11 dhjetor 2004, në sallën e

mbledhjeve të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në Tiranë, sipas grafikut në Aneksin Nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

5. Rezultatet e testimit për vlerësimin e njohurive teorike të shpallen ose ti njoftohen të testuarve, brenda datës 20 dhjetor 2004.
6. Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit, si dhe Administrata e kësaj Zyre, të marrin masat e duhura organizative për të siguruar:
 - 6.1. Ambientin dhe infrastrukturën e nevojshme për të kryer testimin;
 - 6.2. Pjesëmarrjen në testim të të gjithë juristëve-oficerë të policisë gjyqësore të Prokurorisë, sipas datave të planifikuara në Aneksin Nr. 2, bashkëlidhur.
7. Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit, nëpërmjet drejtuesve të Prokurorisë, të njoftojë kundrejt nënshkrimit, për datat e testimit, të gjithë juristët-oficerë të policisë gjyqësore në Prokuroritë e shkallës së parë dhe në Prokuroritë e Apeleve.
8. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, në mbështetje të vendimeve të KM, Nr. 694 datë 21. 10. 1996 dhe Nr. 424 datë 11. 06. 2001 "Për normën mësimore dhe shkencore", si dhe mbështetur në praktikën e shpërblimeve që Shkolla e Magjistraturës, u pagan anëtarëve të komisionit të provimeve të pranimit të kandidatëve për magjistrat, bazuar në vendimet Nr. 7 datë 22. 04. 1996 dhe Nr. 3 datë 26. 07. 2004 të Bordit Drejtuesve kësaj shkolle, të shpërblehen 1100 lekë ora për person të testuar.
9. Me këtë urdhër të njihen anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit dhe Sekretari i Përgjithshëm.
 - 9.1 Juristët-oficerë të policisë gjyqësore të Prokurorisë që do të testohen, para testimit me shkrim, të njihen me procedurat e organizimit të testimit për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre, Aneksi Nr. 1, bashkëlidhur.
 - 9.2 Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë urdhër përbën shkelje të disiplinës në punë.
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
THEODHORI SOLLAKU